



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

GJYKATA THEMELORE PEJË
OSNOVNI SUD PEĆ – BASIC COURT PEJA

P nr. 201/15

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË PEJË D.P, gjyqtari Sejdi Blakaj me sekretaren juridike Gjyljeta Çorkadiu , në lëndën penale kundër të pandehurit V. H., sipas aktakuzës së PTH-së D.P. në Pejë PP/II. nr.2374/14 të dt.05.3.2015, për shkak të veprës penale: të ngacmimit nga neni 186 par 1 të KPRK-së, pas përfundimit të shqyrtimit fillestar , publik dhe me gojë, të mbajtur në praninë e të pandehurit V. H dhe të prokurorit të shtetit Ardita Beqiraj me dt.13.7.2017 ka marrë dhe botërisht ka shpallë këtë:

A K T G J Y K I M

I pandehuri V. H. i lindur me dt. 03.9.1982, në P rruga P .B nr. 7, i biri i N. dhe i M. e gjinisë B, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, gjendet në liri.

ËSHTË FAJTOR

Për arsye se:

Me dt. 15.11.2014 rreth orës 13:20, në Pejë, në rrugën A. K., ku e dëmtuara M. U. e ka shtëpinë , me qëllim të ngacmimit është përfshirë në sjellje të vëmendjes së vazhdueshme dhe me këtë rast i ka shkaktuar shqetësim të dëmtuarës , në atë mënyrë që përderisa e dëmtuara ishte duke kaluar në vendin e lartcekur së bashku me vajzën e saj të mitur me të vërejtur i pandehuri i drejtohet me fjalët “ **ndalu , ndalu se dije se kam me të mbytë vajzën, ruaje tash e mbrapa dhe ty pa u bërë 24 orë kam me të mbytë**” me ç’ rast e dëmtuara e frikësuar vrapon në drejtim të shtëpisë dhe e lajmëron rastin në polici .

-me çka ka kryer vepra penale : të ngacmimit nga neni 186 par 1 të KPRK-së

Prandaj gjykata të pandehurit konform nenit 41, 42, 49, 50,51,52, dhe nenit 186 par 1 të KPRK-së. I SHQIPTON.

DËNIM TË KUSHTËZUAR

Në atë mënyrë që ia përcakton dënimin me burg në kohëzgjatje prej 3 muaj , e të cilin dënim i pandehuri fare nuk do ta vuaj nëse në afat prej 1 viti nuk kryen ndonjë vepër tjetër penale .

Obligohet që emër të paushallit gjyqësorë të paguaj shumën prej 15 euro -15 ditë pasi që aktgjykimi të merr formën e prerë.

E dëmtuari për realizimin eventual të kërkesës pasurore juridike udhëzohet në kontest civil.

Shpenzime procedurale nuk ka pasur .

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Pejë me dt.05.3.2015 kundër të pandehurit V. H , ka ngritë aktakuzë PP/II. nr.2374/14, për vepre penale : të ngacmimit nga neni 186 par 1 të KPRK-së, duke i propozuar gjykatës që pas përfundimit të shqyrtimit gjyqësorë të pandehurin ta shpallë fajtorë , ta dënoj sipas ligjit dhe ta obligoj në pagimin e shpenzimeve procedurale .

Në shqyrtimin fillestarë i pandehuri – pasi që paraprakisht i është lexuar aktakuza , është njoftuar me të drejtat dhe detyrimet procedurale dhe pasojat e pranimi përkatësisht të mos pranimi të fajësisë- e ka pranuar fajësinë dhe ka manifestuar keqardhje për atë që i ka ndodhur. Këtë pranim fajësie gjyqtari – pasi që paraprakisht e ka marrë pëlqimin e prokurorit të shtetit, i bindur se pranim fajësinë i pandehuri e ka bërë ashtu siç e parasheh ligji – vullnetarisht dhe pa u ndikuar nga askush dhe në asnjë mënyrë -e ka pranuar .

Meqenëse i pandehuri e pranoj fajësinë gjyqtari kaloj në marrjen e vendimit lidhur me llojin dhe lartësinë e masës ndëshkuese , me ç rast i pati parasysh të gjitha rrethanat rënduese dhe lehtësuese. Rrethanë rënduese në rastin konkret gjyqtari nuk ka gjetur , kurse nga ato lehtësuese ka çmuar : pranimin e sinqertë të fajësisë , pendimin e thellë për këtë gjë, qëndrimin korrekt në gjykatë, dhe kësaj gjyqtari mendon se edhe me një vendim si në dispozitivin e aktgjykimit ndaj të pandehurit do të arrihet qëllimi i ndëshkimit i paraparë me neni 41 të KPK-së .

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale dhe të paushallit gjyqësor është marrë konform neni 450 të KPPRK-së.

Vendimi mbi udhëzimin e të dëmtuarit në kontestin e rregullt civil është marrë konform neni 463 të KPPRK-së .

Nga sa u tha më lartë konform neni 365 të KPPRK-së u vendos si më lartë.

Nga Gjykata Themelore në Pejë D.P. datë.13.6.2017

Sekretarja juridike
Gjyljeta Çorkadiu

Gjyqtari
Sejdi Blakaj

KËSHILLA JURIDIKE

Kundër këtij aktgjykimi lejohet
Ankesa në afat prej 15 ditësh nga
Dita e marrjes , Gjykatës të Apelit në Prishtinë
E përmes kësaj Gjykate .